VENDIM
Nr.3, datë 6.2.1993

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Rustem Gjata	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Feti Gjilani	Zv/kryetar	i Gjykatës Kushtetuese
Manol Konomi	Anëtar	i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli	Anëtar	i Gjykatës Kushtetuese
Franc Jakova	Anëtar	i Gjykatës Kushtetuese
Veli Budo	Anëtar	i Gjykatës Kushtetuese
Thimjo Kondi	Anëtar	i Gjykatës Kushtetuese
Natasha Sheshi	Anëtare	e Gjykatës Kushtetuese
Ylvi Myrtja	Anëtar	i Gjykatës Kushtetuese

Me sekretare Drita Filto më datën 6.2.1993, shqyrtoi në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.4 që i përket:

kërkuese: Gjykata e Rrethit Tiranë

OBJEKTI:

Papajtueshmëria e urdhërit të Ministrit të Mbrojtjes, të Ministrit të Rendit Publik dhe Kryetarit të Shërbimit Informativ Kombëtar, Nr.Extra, datë 23.7.1992, me ligjin nr.7496, datë 3.7.1991 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi relacionin përkatës,

VËREN:

Me Urdhërin Nr.Extra, datë 23.07.1992, të Ministrit të Mbrojtjes, Ministrit të Rendit Publik dhe Kryetarit të SHIK-ut, janë nxjerrë në lirim para kohe dhe u është hequr titulli oficer aktiv e në rezervë, 49 kuadrove (6 të SHIK-ut, 13 të Ministrisë së Mbrojtjes dhe 20 të Organizatës BKUR) me arsyetimin: "... se me qëllime të caktuara politike për destabilizimin e kundërvënien ndaj reformës në Forcat e Armatosura, kanë bërë grumbullime, organizime të caktuara dhe ankesa kolektive, të cilat bien në kundërshtim me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi".

Në zbatim të pikës 2 të Urdhërit të lartpërmendur, ju është hequr e drejta e trajtimit financiar që përfitonin në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.225, datë 29.05.1992, 29 ish-oficerëve.

Një pjesë prej këtyre ish-oficerëve kanë paditur në gjykatën e rrethit Tiranë punëdhënësit. Disa kanë kërkuar: "Detyrimin e palës së paditur që t'i paguaj çdo muaj rrogën që nga data 23.07.1992 e në vazhdim sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.225, datë 29.05.1992", të tjerët: "Detyrimin e palës së paditur që t'i kthejnë ndalesat e bëra nga paga e të paguajë në vazhdim pagën në bazë të ligjit Nr.7496, datë 03.07.1991 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.225, datë 29.05.1992".

Pasi ka bërë bashkimin e çështjeve në një të vetme, gjykata e rrethit Tiranë, ka pezulluar gjykimin dhe ka dërguar në Gjykatën Kushtetuese të gjitha materialet duke kërkuar të vendoset për ligjshmërinë e Urdhërit Nr.Extra, datë 23.07.1992, me arsyetimin se vjen në kundërshtim me Ligjin "Për statusin e Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.225, datë 29.05.1992 "Për trajtimin financiar të ushtarakëve që dalin në lirim nga zbatimi i reformës në strukturat e Forcave të Armatosura".

Në vendimin e saj Gjykata arsyeton: "Në bazë të ligjit Nr.7495, datë 03.07.1991 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", ushtaraku përfiton një sërë të drejtash, siç është e drejta për pension etj". Vendimin e saj ajo e mbështet në nenin 8 të Ligjit Nr.7561, datë 29.04.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin Nr.7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", ku thuhet: "Kur gjatë shqyrtimit të çështjes gjykata arrin në përfundimin se akti normativ nuk pajtohet me Ligjin "Për dispozitat kryesore kushtetuese" dhe me ligjet, ajo pezullon gjykimin dhe ia dërgon materialet e çështjes Gjykatës Kushtetuese".

Në nenin 8 të ligjit të lartpërmendur ku është mbështetur gjykata bëhet fjalë për akte normative dhe jo për akte individuale. Në këtë vështrim nga gjykata është kuptuar dhe zbatuar gabim neni 8 i ligjit.

Paditësit në gjykatë kanë kërkuar detyrimin e të paditurve për t'i paguar shpërblimin. Këtë shpërblim ish-ushtarakët e liruar për shkak të reformës nuk e merrnin në bazë të Ligjit Nr.7496, datë 03.07.1991 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë" si pension të pjesshëm për vjetërsi shërbimi nga fondi i sigurimeve shoqërore siç arsyeton gjykata, por në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave të cituar më lart dhe nga fondi i dikastereve përkatëse.

Në bazë të nenit 16 të ligjit Nr.7496, datë 03.07.1991 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të drejtën e pensionit të pjesshëm e gëzojnë oficerët dhe nënoficerët me vjetërsi shërbimi në ushtri 15 vjet për burrat dhe 12 vjet për gratë. Kriteret e dhënies së pensionit përcaktohen në Ligjin "Për sigurimet shoqërore" (vazhdim i nenit 16).

Personave që plotësojnë kushtet e nenit 16 të ligjit "Për statusin e ushtarakut" dhe kriteret e Ligjit "Për sigurimet shoqërore", nuk iu është mohuar e drejta për t'u drejtuar sigurimeve shoqërore e për të marrë një pension të pjesshëm për vjetërsi shërbimi. Këtej del përfundimi se urdhëri objekt shqyrtimi nuk është në kundërshtim me Ligjin Nr.7496, datë 03.07.1991 "Për statusin e ushtarakut".

Për rrjedhojë, kërkesa e gjykatës së rrethit Tiranë, nuk është e bazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 24 pika 3 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr. 7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”.

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës së Gjykatës së Rrethit të Tiranës.

Vendimi është përfundimtar dhe i formës së prerë.

Vendimi hyn në fuqi ditën që i njoftohet Gjykatës së rrethit të Tiranës.